

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme me të cilën kryesonte kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Besa Ademi, të mbajtur më 20.09.2024, në bazë të nenit 37 paragrafi (1), nënpika 1 të Ligjit të gjykatave ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr.96/19), neni 63 paragrafi (1) dhe (2) dhe neni 65 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur mbi Iniciativën e avokates Natasha Najdenova Leviq nga Shkupi, për miratimin e qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor, nxori këtë:

K O N K L U Z I O N

Iniciativa e paraqitur nga Natasha Najdenova Leviq, avokate nga Shkupi, evidentuar nën 03Su.nr.514/24 të datës 06.08.2024, **NUK MIRATOHET.**

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) pika 1 të Ligjit të gjykatave, avokatja Natasha Najdenova Leviq nga Shkupi, paraqiti kërkesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të evidentuar nën 03Su.nr.514/24 të datës 06.08.2024, që Seanca e përgjithshme të miratojë qëndrim parimor dhe mendim juridik parimor sipas nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 dhe 3 të Ligjit të gjykatave dhe neni 63 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Paraqitësi në iniciativën thekson se paditësja Snezhana Karakasheva nga Shkupi, ka ngritur padi në Gjykatën Themelore Civile Shkup, më 28.01.2020, të evidentuar nën RO-630/20 kundër të paditurit Shoqëria aksionare për prodhim të energjisë elektrike Elektrani të Maqedonisë së Veriut, në pronësi të shtetit, Shkup, me të cilën kërkohet që të shfuqizohet si i paligjshëm Vendimi për anulimin e kontratës së punësimit dhe ofrimin e një kontrate të re të ndryshuar përpara dorëheqjes së të paditurit numër 04-5206/1 të datës 25.10.2019, si dhe të shfuqizojë Kontratën e ndryshuar për punësim numër 04-5206/2 të datës 25.10.2019, të lidhur ndërmjet të paditurit si punëdhënës dhe paditëses si punonjëse në bazë të vendimit paraprakisht të theksuar për anulimin e kontratës së punësimit dhe ofrimin e një kontrate të re të ndryshuar dhe se gjatë rrjedhjes së procedurës së lëndës është parashtruar një çështje si e kontestuar pa u theksuar se për cilën çështje juridike

konkrete kërkon që Gjykata Supreme të miratojë qëndrim parimor ose mendim juridik parimor. Paraqitësi tregon se Gjykata Themelore Civile Shkup, si gjykatë e shkallës së parë në aktgjykimin e sjellë IX.RO-603/20 të datës 04.05.2022 dhe Gjykatës së Apelit Shkup, si gjykatë e shkallës së dytë në aktgjykimin ROZH-1346/22 të datës 09.02.2023 kanë shprehur mendim juridik se padia të cilën e ka ngritur paditësja është në kohë. Njëkohësisht, pa dallim të asaj që vendimin për anulim të kontratës për punësim me ofrim të një kontratë të re të ndryshuar paditësja i ka pranuar më 28.10.2019, ndërsa ka paraqitur kundërshtim më 16.01.2020, duke u bazuar në atë se Komisioni për mbrojtjen e të drejtave pranë SHA Elektrani në RMV në pronësi të shtetit, Shkup, nuk ka marrë vendim për kundërshtimin, në mënyrë që padia në fjalë është ngritur më 28.01.2020.

Në kërkesën njëkohësisht shprehet pakënaqësia nga aktvendimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut REV3-43/23 të datës 06.03.2024, me të cilin aktgjykimet e sipër cekura të gjykatave më të ulëta janë të abroguara. Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka treguar se nuk janë të qarta arsyet për pranimin e padisë së paraqitur në kohë, ngase nuk është theksuar asnjë provë nga e cila është konstatuar ajo. Në aktvendimin e përmendur bëhet me dije se deklarimi i kundërshtimit pasi ka kaluar një periudhë kohore më i gjatë se 8 ditë si afat i paraparë ligjor, nuk mund të pranohet se është arritur mbrojtja parësore, e cila është parakusht që mbrojtja e mëtejshme e këtyre të drejtave nga marrëdhënia e punës të arrihet me padi. Më tej, paraqitësi thekson se veç më ekziston një praktikë gjyqësore për raste të tilla sipas të cilës gjykata kompetente nuk ka autorizim të vlerësojë afatin e kundërshtimit duke iu referuar vendimit ASS GZH.nr.256/02 të datës 30.01.2020 dhe duke theksuar se me këtë qëndrim është edhe Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut Rev3.nr. 103/13 të datës 26.02.2014.

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit të gjykatave, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore mbi çështje të rëndësishme për sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjeve nga gjykatat në afat prej 3 muajve, por jo më gjatë se 6 muaj me vetiniciativë, me iniciativë të kryetarit të gjykatës apo me iniciativë të seancave të gjyqtarëve apo sektorëve gjyqësor të gjykatave apo me iniciativë të avokatëve dhe i publikon në ueb faqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut konstatoi se, në aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut REV3-43/23 të datës 06.03.2024, nuk është dhënë ndonjë arsyetim ndryshe nga kumtimi i aktvendimit të së njëjtës gjykatë REV3-103/2013 të datës 26.02.2014, nga aspekti i asaj që kundërshtimi i deklaruar jo në kohë nuk ka ndikim në mundësinë e realizimit të së drejtave në procedurën e mëtejme gjyqësore, por përkundrazi në dy vendimet e përmendura gjyqësore është sqaruar se gjatë vlerësimit të vendimeve të gjykatave më të ulëta, si objekt vlerësimi ligjor ka qenë rrethana se mbrojtja parësore para komisionit kompetent nuk është realizuar në afatin e paraparë ligjor prej 8 ditësh, gjë kjo që tregon për një padi të paraqitur jo në kohë në gjykatën kompetente.

Për arsyet e sipërpërmendura që në vendimet revizore nuk rezulton mendim i ndryshëm juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut lidhur me çështjen e theksuar juridike, as nga paraqitësi nuk janë theksuar dhe bashkëngjitur vendime të tjera gjyqësore se është bërë shkelja e parimit të unitetit në zbatimin e ligjeve nga gjykatat, Seanca e përgjithshme konstatoi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 37 paragrafi (1) të Ligjit të gjykatave, për miratim të qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor.

**SEANCA E PËRGJITHSHME E GJYKATËS SUPREME
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**